

NË EMËR TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, Departamenti I Përgjithshëm penal, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Shabi Idrizi , Sek. Juridike Shpresa Hoxha , në qështjen penale të akuzuarit [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] K-Kaçanik i akuzuar se ka kryer veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 të KPRK-së, sipas aktit akuzues të PTh-Ferizaj, PP/II.Nr. 2320-6/14, të datës 11.08.2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, oral dhe publik me datën 13.12.2016, në prani të përfaqësuesit të PTh-Ferizaj Agim Kuka, dhe të akuzuarit [REDAKTUAR] [REDAKTUAR] muarr dhe shpalli këtë;

A K T G J Y K I M

I akuzuari [REDAKTUAR] nga i ati [REDAKTUAR] dhe nëna V [REDAKTUAR] e lindur [REDAKTUAR] i lindur [REDAKTUAR] në f. [REDAKTUAR] , Komuna e Kaçanikut ku edhe jeton, pregaditja shkollore shkolla fillore, i papunë, i gjendjes së varfër ekonomike, , i pamartuar, I denuar edhe me parë, shqiptar nënshtetas Kosovar, mbrohet në liri, numri personal [REDAKTUAR] mbrohet në liri.

Ë S H T Ë F A J T O R

Me dt 19.08.2014 rreth orës 12:40 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Autoriteti Pyjor Komunal-Hani i Elezit në rajonin ekonomik pyjor Bodoshnjak në vendin e quajtur " Kodra e Vathit ", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 4 copa dru të llojit shkozë me dimensione të gjatë 15 m, me diametër 36 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 2.96 m. kub të cilat i ka bartur me kali samari, vlera e dëmit të shkaktuar është 399.60 €

Me këtë veprim kreu veprën penale vjedhje pylli nga neni 358 par 1 i KPRK-së
Andaj gjykata duke u bazuar me dispozitat e nenit 3, 11, 15, 41, 47, neneve 73,75, të KPK dhe nenit 365 , 453 dhe 463 të KPPK-së e

G J Y K O N

Të pandehurit [REDAKTUAR] i shqipton, Urdhër për punë të dobishme në kohëzgjatje prej 80 orëve pune e cila do te kryhet në afat prej nje 1 viti pas plotfuqishmërise se këtij aktgjykimi dhe ne rast mosbindje se urdhrit i njëjti do të i shendrohet ne burg.

Udhzohet e dëmtuara që kërkesën pasuroro-juridike ta relaizoj në kontst civil.

Oblogohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej 40.00 euro.

A r s y e t i m

PTH nga Ferizaji, me aktin akuzues .PP/II. Nr. 2320-6/14 të datës 11.08.2015, të akuzuarin [REDAKTUAR] nga f. [REDAKTUAR] K-Kaçanik e ka akuzuar për shkak veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragrafi 1 të KPRK-së.

Në shqyrtimin gjyqsor Prokurori shtetror pranë PTH-Ferizaj Agim Kuka në fjalën përfundimtare mbeti në tërsi pranë aktit akuzues të paraqitur me shkrim pranë kësaj gjykate pa ndryshime dhe plotsime, duke propozuar gjykatës që të akuzuarin [REDAKTUAR] të e shpall fajtor për veprën penale që akuzohet dhe ti shqiptojë denim meritore sipas ligjit, ngase gjendja faktike dhe kualifikimi juridik si në dispozitivin e aktakuzës u vertetua sot në shqyrtimin gjyqsor nga deklarimi i dëshmitarit [REDAKTUAR] por edhe nga pranimi i peshëm i fajsisë nga ana e të akuzuarit . Njiherit i ka propozuar gjykatës që gjatë matjes dhe shqiptimit së denimit ti ketë parsysh si rrethanat lehtësuese pranimin e peshëm fajsisë , gjendjen e veshtirë ekonomike , por edhe ato rënduese recidivizimin e veprimeve të tij.

I akuzuari [REDAKTUAR] në mbrotjen e tij në shqyrtimin gjyqsor në tërsi e ka mohuar kryerjen e veprës penale që i vehet në barrë dhe i propozon gjykatës që ta lorio nga përgjegjësia penale ngase ai ka marrë vetëm drunj të thatë e kurrsesi nuk ka prerë drunj të njomë.

Në procedurën e provave gjykata bëri degjimin e dëshmitarit , [REDAKTUAR] , rojtar pylli pranë [REDAKTUAR] në Han të Elezit i cili deklaroi njejtë si në përmbajtjen e proceqverbalit me 152/14 të dt. 22.09.2014 dhe se deklaroi se është i njejti person që e ka takuar në vendngjarje në datën kritike.

Mandej Gjykata ka bere leximin e provave materiale proqesverbalet e lartçekura të përpiluar nga rojtati i pyllit dëshmitari i larpërmendur [REDAKTUAR] .

Gjykata ka bere vlersimin e provave te shqyrtuara nje nga nje dhe te gjitha sbashku dhe ka konstatuar kete gjendje faktike; Me dt 19.08.2014 rreth orës 12:40 në pyllin shoqërorë të cilin e menaxhon Autoriteti Pyjor Komunal-Hani i Elezit në rajonin ekonomik pyjor Bodoshnjak në vendin e quajtur " Kodra e Vathit ", me qëllim vjedhje me sharrë motorike ka prerë 4 copa dru të llojit shkozë me dimensione të gjatë 15 m, me diametër 36 cm, gjithsejtë në kubaturë prej 2.96 m. kub të cilat i ka bartur me kali samari, vlera e dëmit të shkaktuar është 399.60 €

kjo vertetohet ngas deklarata e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili deklaroi se të akuzuarin e kishte takuar në vendin e lartpërmendur si në dispozitivin e aktit akuzues dhe se aty ka qenë i njejti person që sot është në shqyrtim porse

njiherit kjo terthorazi vertetohet edhe nga deklarata e vet te akuzuarit i cili deklaronte se kjo është e vertet porse ai ka prerë dru të thata e jo të njoma.

Gjykata vleron se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje pylli nga neni 358 paragraf 1 të KPK-së, për të cilën vepra e akuzuarit është penalishtë përgjegjës dhe është ndeshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi. Ky vlersim është i bazuar në pranimin e pjeshem të fajsisë nga ana e të akuzuarit, deshmia e deshmëtarit [REDAKTUAR] porse edhe nga provat materiale si Proceverbalet nga vendi i ngjarjes i bërë nga ana e rojtarit të pyllit ku vertetohet plotsisht se me dt. E lartëcekura akuzuari ka kryer veprën penale siq është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjës së denimit gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 75 i KPK-së të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka marrë për bazë; pranimin e pjeshem të fajsisë gjendjen ekonomike të akuzuarit, pendimin e tij, sjelljen e mirë të tij gjatë tërë procedurës si dhe në shqyrtimin gjyqsor, ndërsa rrethanë rënduese se kjo vepër penale është dukuri e shpeshtë dhe mjaftë e përhapur.

Gjykata është e bindur se denimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me shkallën e përgjegjësise penale të tij dhe peshën e veprës penale, keshtu që denimi i shqiptuar në lartësi prej 80 orëve pune pune në dobi të përgjithshme, do arrihet qëllimi i denimit i parapaprë me nenin 41 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPRK-së.

Vendimin mbi udhëzimin e palës së demtuar është i bazuar në nenin 463 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P. nr. 300/15, me dt. 13.12.2016

Sek. Juridike,
Shpresa Hoxha

Gjyqtari
Shabi Idrizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, pala e paknaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.

REPUBLIKA E KOSOVES
DEGA NE FERIZAJ
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA NE KACANIK
10.01.2017

